



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

**ENTI RREGULLATOR I ENERGJISË
BORDI**

VENDIM

Nr. 161, Datë 20.10.2020

**“MBI
MOSFILLIMIN E PROCEDURËS PËR RINOVIMIN E LICENCËS SË SHOQËRISË
“ENERGIJA D.O.O VETERNIK” NR. 317, SERIA F15, NË VEPRIMTARINË E
FURNIZIMIT TË ENERGJISË ELEKTRIKE, TË MIRATUAR ME VENDIMIN E
BORDIT TË KOMISIONERËVE TË ERE-S NR. 141, DATË 21.11.2015”.**

Në mbështetje të nenit 16 të Ligjit nr. 43/2015 “Për sektorin e energjisë elektrike”, i ndryshuar; nenit 10, pikat 1, 2 dhe 3 dhe nenit 16, pika 1, të “Rregullores për procedurat dhe afatet për dhënien, modifikimin, transferimin, rinovimin ose heqjen e licencave në sektorin e energjisë elektrike”, të miratuar me vendimin e bordit të ERE-s nr.109, datë 29.06.2016, e ndryshuar, dhe nenit 19, pika 1, gërma “a” të “Rregullores për organizimin, funksionimin dhe procedurat e ERE-s”, miratuar me vendimin nr. 96, datë 17.06.2016, Bordi i Entit Rregullator të Energjisë (ERE) në mbledhjen e tij të datës 20.10.2020, mbasi shqyrtoi relacionin me nr. 109/5 prot, datë 13.10.2020, të përgatitur nga Drejtoria e Licencimit, Autorizimeve dhe Mbikqyrjes mbi kërkesën e shoqërisë “Energija D.O.O Veternik” sh.p.k., për rinovim licence në veprimtarinë e furnizimit të energjisë elektrike,

Konstatoi se:

- Shoqëria “Energija D.O.O Veternik” sh.p.k., me shkresën e protokolluar në ERE me nr. 1086 Prot, datë 06.10.2020, ka paraqitur kërkesën për rinovimin e licencës në veprimtarinë e furnizimit të energjisë elektrike.
- Kjo shoqëri është një subjekt tregtar i krijuar si detyrim i ligjit nr. 9901, datë 14.04.2008, “Për tregtarët dhe shoqëritë tregtare”, i ndryshuar. Në datën 06.01.2015 është regjistruar pranë QKB, si shoqëri me përgjegjësi të kufizuar (shpk), konform ligjit nr. 9723, datë 03.05.2007 “Për qendrën kombëtare të biznesit” (QKB) .
- Shoqëria “Energija D.O.O Veternik” sh.p.k., është mbajtëse e licencës me nr. 317, Seria F15, në veprimtarinë e furnizimit të energjisë elektrike, të miratuar me vendimin e Bordit të Komisionerëve të ERE-s nr. 141, datë 21.11.2015.
- Afati i fundit për aplikim nga shoqëria “Energija D.O.O Veternik” sh.p.k, për rinovimin e kësaj licence, referuar *Rregullores për procedurat dhe afatet për dhënien, modifikimin, transferimin, rinovimin ose heqjen e licencave në sektorin e energjisë elektrike* ishte data 21.09.2020.

- Shoqëria “Energija D.O.O Veternik”, sh.p.k nuk ka aplikuar brenda afatit ligjor të nevojshëm për rinovimin e licencës, pasi aplikimi i saj është paraqitur në ERE në datën 06.10.2020.
- Shoqëria “Energija D.O.O Veternik” sh.p.k., ka kryer pagesën për aplikimin për rinovim.
- Shoqëria “Energija D.O.O Veternik” sh.p.k., ka depozituar një dokumentacion të konsiderueshëm bashkëlidhur aplikimit të saj për rinovim të licencës në veprimtarinë e furnizimit të energjisë elektrike, por ky aplikim nuk është paraqitur në afat sipas kërkesave të “Rregullores për procedurat dhe afatet për dhënien, modifikimin, transferimin, rinovimin ose heqjen e licencave në sektorin e energjisë elektrike”.
- Sipas nenit 10 pika 7 të “Rregullores për procedurat dhe afatet për dhënien, modifikimin, transferimin, rinovimin dhe heqjen e licencave në sektorin e energjisë elektrike”, “Nëse aplikuesi paraqet aplikimin e ri në përputhje me pikën 6 të këtij neni brenda 1 muaji nga marrja e vendimit për mosfillimin e procedurës për shqyrtimin e aplikimit, dokumentacioni i paraqitur për aplikimin e mëparshëm dhe pagesa për aplikim do të konsiderohet i vlefshëm për aplikimin e ri.

Për gjithë sa më sipër, bordi i ERE-s,

Vendosi:

1. Të mos fillojë procedurën për rinovimin e licencës së shoqërisë “Energija D.O.O Veternik” sh.p.k., në veprimtarinë e furnizimit të energjisë elektrike, nr. 317, Seria F15, të miratuar me vendimin e Bordit të Komisionerëve të ERE-s nr. 141, datë 21.11.2015.
2. Drejtoria Juridike dhe Zgjidhjes së Mosmarrëveshjeve, të njoftojë aplikuesin për vendimin e bordit të ERE-s.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Për këtë vendim mund të kërkohet rishikim në ERE brenda 7 ditëve kalendarike si dhe mund të bëhet ankim në Gjykatën Administrative Tiranë, brenda 45 ditëve kalendarike nga dita e publikimit në Fletoren Zyrtare.

Ky vendim botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYETARI I ERE
Petrit AHMETI